



EKSTRAKT I PROCESVERBALIT

**të mbledhjes së shtatë të Komitetit për Politikë dhe Financa të Kuvendit të
Komunës së Prishtinës, mbajtur më 5.7.2012, e cila filloi në orën 15 : 00.**

Në mbledhje ishin të pranishëm: Sami Hamiti, Mustafë Krasniqi, Tefik Mehmeti, Hazir Borovci, Aziz Pacolli, Milazim Vitia, Shemsi Veseli dhe Shefqet Sylejmani.

Në mbledhje mungoi Engin Beyoglu.

Morën pjesë edhe drejtorët e drejtorive të Komunës dhe përfaqësuesit e OSBE-së.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Sami Hamiti, kryesues.

Para se të miratohej rendi i ditës, kryesuesi propozoi që për këtë mbledhje të futet në rend dite edhe Propozimvendimi për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit të banimit për rastet me përkujdesje sociale dhe të objektit të banimit për familjet e dëshmorëve, invalidët dhe veteranët e luftës dhe nevojat e shpronësimeve.

Njëzëri u miratua ky

R E N D I T E :

- 1. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së gjashtë;**
- 2. Raporti i Kryetarit të Komunës për situatën ekonomike - financiare të Komunës dhe për zbatimin e planeve investuese për periudhën janar - qershor 2012;**
- 3. Propozimvendimi për fillimin e hartimit të Planit rregullues urban të lagjes “Mati 2” ;**
- 4. Propozimvendimi për fillimin e ndryshimit dhe plotësimit të Planit rregullues urban të lagjes “Lakërishta”;**
- 5. Propozimvendimi për fillimin e ndryshimit dhe plotësimit të Planit rregullues urban të lagjes “Sofalia”;**
- 6. Propozimvendimi për fillimin e ndryshimit dhe plotësimit të Planit rregullues urban të lagjes “Arbëria 3”;**
- 7. Propozimvendimi për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit të sallës universale kulturore në Prishtinë;**
- 8. Propozimvendimi për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit të banimit për rastet me përkujdesje sociale dhe të objektit të banimit për familjet e dëshmorëve, invalidët dhe veteranët e luftës dhe nevojat e shpronësimeve;**
- 8. Të ndryshme.**

Pika e parë

Mustafë Krasniqi bëri vërejtje në ekstraktin e procesverbalit të mbledhjes së kaluar, duke thënë se diskutimit të tij lidhur me pikën e dytë të rendit të ditës, duhet shtuar: "... në pjesën e rrugës magjistrale, ana e majtë duhet të ketë edhe një qasje ", si dhe në fjalinë e dytë duhet shtuar fjala "punën".

Njëzëri u miratua ekstrakti i procesverbalit të mbledhjes së gjashtë të KPF-së, me vërejtjet e dhëna.

Pika e dytë

Avdullah Hoti paraqiti Raportin e Kryetarit të Komunës për situatën ekonomike – financiare të Komunës dhe për zbatimin e planeve investuese për periudhën janar - qershor 2012, duke shtuar se Komuna e Prishtinës për këtë vit ka një buxhet në vlerë prej 61,741,684 €, ku 21,752,189 € vijnë nga të hyrat vetanake, ndërsa pjesa tjetër nga grantet qeveritare. Ai gjithashtu shtoi se arkëtimi është më i mirë se vitin e kaluar, por përveç donacioneve të paraqitura në këtë raport ka edhe donacione tjera që nuk janë paraqitur.

Shemsi Veseli përshëndeti punën që është bërë, por tha se qëndron pas asaj që parasheh Ligji për menaxhim dhe financa, ku thuhet se kryetari duhet paraqitur raporte tremujore. Ekziston një transparencë lidhur me disa çështje, por disa gjëra mund të ishin më mirë. Në Drejtorinë e Urbanizmit, Ndërtimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit shihet një punë më e madhe, por ka pasur mundësi të bëhet më shumë në arkëtimin më të madh të mjeteve nga projektet më madhore. Participimi nga donacionet ka mundur të ishte më i mirë, e po ashtu edhe transaksioni i pronës. Shfrytëzimi i sipërfaqeve publike nuk është paraqitur në mënyrë reale. Ai gjithashtu shtoi se është mirë të jetë një transparencë më e madhe dhe të analizohen të hyrat nga shëndetësia. Ai shprehu mbështetje për ekzekutivin për të gjitha projektet madhore.

Kryesuesi dha sqarime lidhur me kërkesën për paraqitjen e raporteve tremujore.

Tefik Mehmeti tha se raporti në fjalë na jep një pasqyrë të përgjithshme dhe se pikat e përditshme nuk ka nevojë të paraqiten, pasi që raporti bëhet shumë i zgjeruar. Është për lëvdatë realizimi i buxhetit për të hyrat vetanake, por edhe shpenzimet buxhetore dhe aktivitetet tjera, si mirëqenia sociale etj., janë në rrugë të mbarë. Te investimet kapitale është një listë e gjerë e aktiviteteve, ndërkaq në lëmin e infrastrukturës lokale janë bërë disa lëshime, si te pikat: 19, 20 etj. andaj duhet të përmirësohen para se të dërgohen në mbledhjen e Kuvendit. Është mirë që të shfrytëzohet partneriteti publiko - privat, ndërkaq sa i përket ndërmarrjeve publike, nuk kemi nevojë të lëshohemi.

Shefqet Sylejmani tha se ndryshimet e shpeshta në ligje, siç është në këtë rast Ligji për financa, ndonjëherë nuk përfillen, andaj në disa raste na vë në lajthitje, sepse në njërin parashihet afati prej tre, ndërsa në tjetrin gjashtë muaj për paraqitjen e raporteve. Konsideroj që edhe kjo vonesë, por edhe të tjerat, e kanë justifikimin e vet. Në këtë raport disa mungesa për realizimin e planifikimeve, e që janë më të shkurtra,

e kanë arsyen e vet. Ekziston një rënie financiare te qytetarët, e cila reflekton në shumë aspekte. Raporti në përgjithësi është i pranueshëm dhe jemi për miratimin e tij.

Aziz Pacolli u pajtua me vërejtjet e dhëna, duke thënë se ka gabime teknike, si në faqen 5, pikat 19 dhe 20, të cilat duhet përmirësuar. Ai gjithashtu shtoi se ka pasur diskutime edhe me qytetarë dhe kërkoi që kërkesat e tyre të përfshihen në raport.

Lidhur me përfshirjen e kërkesave të qytetarëve në raport, kryesuesi shtoi se ato duhet të përfshihen në raportin e vitit 2013.

U konstatua se u përkrah Raporti i Kryetarit të Komunës për situatën ekonomike - financiare të Komunës dhe për zbatimin e planeve investuese për periudhën janar - qershor 2012, me vërejtje, dhe i dërgohet Kuvendit për shqyrtim .

Pika e tretë

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës informoi **Behxhet Musliu**.

Shemsi Veseli u shpreh në mbështetje të këtij propozimi. Me rëndësi është që Prishtina t'i ketë të gjitha planet rregulluese në përputhje me gjendjen faktike në terren dhe uroj që të bëhet diç edhe për lagjen "Kodra e Trimave 1 dh 2", pasi që edhe ajo pjesë e qytetit ka nevojë të rregullohet.

Shefqet Sylejmani tha se i bashkëngjitëm këtij urime dhe shtoi se është i vetëdijshëm që prapa asnjë plani rregullues nuk mund të vihet pikë, por jemi dëshmitar të asaj se duhet të bëhen ndryshime dhe plotësime, e po ashtu do të ndodhë edhe me këto propozime të ditës së sotme. Kërkoi që drejtoria të jetë më e pranishme në terren dhe të merret më shumë me këtë problematikë, duke shtuar se e përkrahin këtë propozim.

U konstatua se njëzëri u përkrah Propozimvendimi për fillimin e hartimit të Planit rregullues urban të lagjes "Mati 2" dhe i dërgohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

Pika e katërt, pestë dhe gjashtë

Arsyetimin lidhur me këto pika të rendit të ditës e paraqiti **Behxhet Musliu**.

Mustafë Krasniqi përkrahu fillimin e ndryshimit të këtyre planeve rregulluese, duke shtuar se këto punë duhet t'i marrim më me seriozitet.

Aziz Pacolli shprehu mendimin se duhet treguar kujdes, sepse ka vende ku dihet se pronat janë tërësisht komunale.

Shemsi Veseli tha se nenet 15 dhe 20 të Ligjit për planifikim hapësinor kushtëzojnë që planet rregulluese mund të ndryshohen çdo pesë vjet. Për shkak të zhvillimit të Prishtinës, është dashur të intervenojnë, pasi që nuk ka tanguar me realitetin, për çka kryesisht është bërë punë kabineti. Është për t'u përsëritet fillimi i hartimit të këtyre planeve rregulluese, pasi që gjendja faktike ka ndryshuar, andaj duhet ndryshuar edhe planet. Ai u shpreh në mbështetje të këtyre tri pikave të rendit të ditës, duke cekur se duhet dhënë llogari për lagjen "Sofalia".

Tefik Mehmeti theksoi se duhet të bëhet ndryshim aty ku është e nevojshme, ndërkaq sa i përket infrastrukturës përcjellëse, mjetet që grumbullohen prej asaj pjese, duhet të shkojnë në atë infrastrukturë dhe të intervenohet në atë pjesë.

Behxhet Musliu paraqiti sqarime shtesë.

U konstatua se njëzëri u përkrahën: Propozimvendimi për fillimin e ndryshimit dhe plotësimit të Planit rregullues urban të lagjes “Lakrishta”; Propozimvendimi për fillimin e ndryshimit dhe plotësimit të Planit rregullues urban të lagjes “Sofalia” dhe Propozimvendimi për fillimin e ndryshimit dhe plotësimit të Planit rregullues urban të lagjes “Arbëria 3” dhe i dërgohen Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

Pika e shtatë

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës të pranishmit i informoi **Vlora Dumoshi**, ndërsa për aspektin hapësinor teknik informoi **Behxhet Musliu**.

U konstatua se njëzëri u përkrah Propozimvendimi për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit të Sallës universale kulturore në Prishtinë dhe i dërgohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

Pika e tetë

Lidhur me Propozimvendimin për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit të banimit për rastet me përkujdesje sociale dhe të objektit të banimit për familjet e dëshmorëve, invalidët dhe veteranët e luftës dhe nevojat e shpronësimeve, informoi **Behxhet Musliu**.

Shemsi Veseli përshëndeti një vendim të tillë, sidomos për disa familje të dëshmorëve, duke shtuar se nëse mendohet se do të ketë manipulime gjatë ndarjes së banesave, atëherë do të jenë në lajthitje, meqë në të kaluarën ka pasur shkelje të kriterëve. Ai gjithashtu shtoi se e kemi arritur një hap, pasi që ky është projekti i tretë dhe me këtë do të bëhet një zgjidhje e mirë.

Kryesuesi shtoi se kjo ka qenë kërkesë e të gjithë pjesëmarrësve. Këto familje duhet ndihmuar, sepse janë të shenjtja.

Shemsi Veseli tha se përzgjedhjen e kanë lënë në ndërgjegjen e anëtarëve të komisionit dhe nëse ata kanë bërë përzgjedhje të gabuar dhe tendencioze, atëherë ajo nuk do të mbetet te ne.

U konstatua se njëzëri u përkrah Propozimvendimin për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit të banimit për rastet me përkujdesje sociale dhe të objektit të banimit për familjet e dëshmorëve, invalidët dhe veteranët e luftës dhe nevojat e shpronësimeve, dhe i dërgohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

Pika e nëntë
Të ndryshme

Shemsi Veseli kërkoi që të rregullohet çështja lidhur me kontestin pronësor te rruga "B ", ku Arben Mecina është duke e ndërtuar një bllok banimi, andaj kërkoj që të mos pengohet në procedurë administrative. E njëjta vlen edhe për Anton Nokën, të cilit i është marrë toka e cila duhet ti kompensohet.

Kryesuesi shtoi se është mirë të mbahet një seancë dhe të shqyrtohen këto çështje, në mënyrë që të kryhen të gjitha rastet.

Behxhet Musliu paraqiti sqarime lidhur me këto raste dhe me raste të ngjashme, duke shtuar se nëse ne nuk mund të bëjmë zgjidhje për tri vite, atëherë rasti duhet të kalojë në gjykatën kompetente.

Mbledhja mbaroi në orën 16:20.

Procesmbajtësja
Alije Gusia

Kryesuesi i Komitetit
Sami Hamiti, ecc.i dipl.